

NJOFTIM PUNE

Profili i kompanisë: Balkan Finance Investment Group Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

ACREM është pjesë e BALFIN Group e specializuar në ofrimin e menaxhimit të pasurive të paluajtshme të BALFIN Group dhe jo vetëm, si dhe shërbimeve operative në to.

Pozicioni: Patrullues Sigurimi
Departmenti: Sigurisë së Brendshme
Vendodhja: Tiranë

Përshkrimi i Pozicionit të Punës

Është përgjegjës për kryerjen e vëzhgimeve në terren në funksion të sigurimit të ambienteve të qendrës tregtare për të garantuar qetësi dhe siguri për klientet gjatë kohës së qëndrimit në njësitë tregtare apo njësite e tjera të biznesit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen survejimin në terren të ambienteve të përbashkëta, dyqaneve, zonave të shërbimeve, zyrave në respektim të rregullores të vendosur nga Departamenti i Sigurisë apo Menaxhimi i njësisë dhe kryen raportimet orare/ditore për shkeljet përkatëse nese do të ketë.
- Survejon për mirëfunksionimin e përgjithshëm të njësisë/ dyqaneve/ zyrave etj dhe raporton rast pas rasti sipas kërkesave të supervisorëve apo menaxhimit.
- Pikas raste të vecanta të klienteve që shfaqin sjellje problematike duke vënë në dijeni menjëherë supervisorët apo menaxherët.
- Raporton menjëherë veprimet që bien ndesh me ligjin apo rregulloren e brendshme të qendrës.
- Bashkëpunon në ekip për kryerjen e detyrave dhe mbarevajtjen e sigurisë së brendshme të ambientit.

Kërkesa dhe kualifikime:

- Të ketë kualifikime përkatëse në këtë fushë dhe një përvojë pune jo më pak se 3 vite (në privat apo shtet).
- Preferohet të ketë kryer arsimin e lartë.
- Aftësi të mira të liderimit dhe menaxhim të grupit.
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi.
- Aftësi të lartë vetëkontrolli, maturie dhe të punës nën presion.
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera përben avantazh.

Mënyra e aplikimit:

Për të aplikuar për këtë pozicion, ju lutem dërgoni elektronikisht CV-n tuaj në adresën email: hr@acrem.al
Për dorëzim të CV-ve mund të paraqiteni në TEG pranë pikës së informacionit kati 0

Mbyllja e aplikimeve në dt. 20.08.2021

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*